



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 dhjetor 2020
Nr. ref.:RK 1680/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI117/20

Parashtrues

Isuf Musliu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së mungesës së vendimeve gjyqësore
lidhur me kërkesën për kompensim material dhe kthim në punë në
Universitetin e Prishtinës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Isuf Musliu, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik. Ai ankohet për mungesë të vendimeve gjyqësore lidhur me kërkesën e tij për kompensim material për ligjëratat e mbajtura dhe kthim në punë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” (në tekstin e mëtejme: Universiteti i Prishtinës).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së mungesës së vendimeve gjyqësore lidhur me kërkesën për kompensim material për ligjëratat e mbajtura dhe kthim në punë në Universitetin e Prishtinës.
4. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) pretendon se i janë cenuar por kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendos për *“kompensim material prej vitit 2008 deri më sot dhe kthim në punë si profesor në UP ose Rektor”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 3 gusht 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Me 7 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë të cilën i kishte drejtuar Senatit dhe Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, ku kishte kërkuar kompensim material dhe kthim në punë në Universitetin e Prishtinës.
9. Më 12 gusht 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës. Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të njoftoj Gjykatën në lidhje me procedurën që është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore sa i përket padisë së parashtruesit të kërkesës.
10. Më 18 shtator 2020, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës përgjigjen e saj lidhur statusin e padisë e parashtruesit të kërkesës.

11. Më 11 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 25 maj 2016 parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër Rektoratit të Universitetit të Prishtinës duke kërkuar kompensimin e të ardhurave dhe honorarëve për ligjëratat që parashtruesi pretendon se i ka mbajtur në Universitetin e Prishtinës dhe atë të Prizrenit, si dhe kthimin në vendin e punës si ligjërues në Universitetin e Prishtinës.
13. Më 23 prill 2019 ishte caktuar seancë përgatitore lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës e cila ishte shtyrë me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për datën 20 maj 2019, ndërsa seanca e 20 majit 2019 ishte shtyrë sërish me kërkesës e parashtruesit të kërkesës për datën 15 korrik 2019.
14. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 20 maj 2019, parashtruesi i kërkesës kishte bërë precizimin e padisë së lartcekur kundër Rektoratit të Universitetit të Prishtinës duke kërkuar *“kompensimin për ligjëratat e mbajtura gjatë viti 2012-2013” dhe “kthimin në vendin e punës së ligjëruesit”* në Universitetin e Prishtinës.
15. Më 15 korrik 2019, Gjykata Themelore kishte mbajtur seancën përgatitore, lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës në të cilën përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata Themelore *“që zyrtarisht të kërkojë nga Fakulteti i Edukimit në Prizren, që t’i sigurojë në origjinal listat e pjesëmarrësve në ligjërata, programi për avancim dhe kualifikimin e mësimeve në historinë e Gjuhës Shqipe gjatë viteve 2012-2013 të Prof. Dr. Isuf Musliu.”* Gjykata Themelore e kishte aprovuar këtë kërkesë të parashtruesit të kërkesës.
16. Më 20 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar shkresën *“Urgjencë ankesore”* në Gjykatën Themelore lidhur me padinë për kompensim dhe kthim në punë C.nr.1188/16, duke kërkuar që seanca lidhur me rastin të mbahet sa më shpejtë.
17. Aktualisht procedura lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës është duke i zhvilluar në Gjykatën Themelore, e cila sipas Gjykatës Themelore *“është me prioritet ligjor dhe e njëjta do të procedohet brenda kohës së arsyeshme, sipas radhës së lëndëve me prioritet të njëjtë”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi konteston mungesën e vendimeve gjyqësore lidhur me kërkesën për kompensim material për ligjëratat e mbajtura dhe kthim në punë si profesor në Universitetin e Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë cenuar por kërkon specifikisht nga Gjykata që të vendos për *“kompensim*

material prej vitit 2008 deri më sot dhe kthim në punë si profesor në UP ose Rektor”.

19. Lidhur me këtë, ai thekson se *“i provova të gjitha Gjykatat, duke filluar nga ato Themelore, Apelit, Supreme të cilat për mendimin tim janë treguar neglizhente dhe të paafta për ta kryer lëndën në një afat te caktuar për të cilat nuk kanë treguar kurrfarë afati ligjor, juridik dhe moral.”* Ai shton se *“Ankesat e mia gjenden në Gjykatat e tjera të cilat nuk më kanë ofruar asnjë përgjigje, prej vitit 2008 deri me sot.”*
20. Ai thekson më tej se, *“Unë nuk po kërkoj asgjë jashtë ligjore, vetëm kompensimin tim si profesor në Universitetin e Prishtinës ose Rektor për të cilin post jam kandidat potencial dhe gjithmonë i futur në listën e ngushtë, po për shkaqe politike me eliminonë nga lista.”*
21. Andaj, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës duke kërkuar *“kompensim material prej vitit 2008 deri me sot dhe kthimin në punë si profesor ordinar në UP ose Rektor.”*

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenin 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, që përcakton:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:

*Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë*

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar”.

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi konteston mungesën e vendimeve gjyqësore lidhur me kërkesën për kompensim material për ligjëratat e mbajtura dhe kthim në punë si profesor në Universitetin e Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë cenuar. Parashtruesi i kërkon specifikisht që Gjykata të vendos për kërkesën tij për *“kompensim material prej vitit 2008 deri më sot dhe kthim në punë si profesor në UP ose Rektor”*.
27. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Gjykatës Themelore me padi kundër Rektoratit të Universitetit të Prishtinës duke kërkuar kompensimin e të ardhurave dhe honorarëve për ligjëratat që parashtruesi pretendon se i ka mbajtur në Universitetin e Prishtinës dhe atë të Prizrenit, si dhe kthimin në vendin e punës si ligjërues në Universitetin e Prishtinës.
28. Gjykata vëren se lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore kishte caktuar dy herë seanca përgatitore, konkretisht për datën 23 prill 2019 dhe 20 maj 2019 të cilat ishin shtyrë me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Më 15 korrik 2019, Gjykata Themelore kishte mbajtur seancën përgatitore, lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës në të cilën ishte aprovuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës që të kërkohej informata nga Fakulteti i Edukimit në Prizren për ligjëratat e mbajtura nga parashtruesi i kërkesës. Për më tepër Gjykata Themelore në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës theksoi se lënda e parashtruesit të kërkesës *“është me prioritet ligjor dhe e njëjta do të procedohet brenda kohës së arsyeshme, sipas radhës së lëndëve me prioritet të njëjtë”*.
29. Në këtë kontekst, rezulton se lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës është duke i zhvilluar procedura gjyqësore para Gjykatës Themelore e cila ende nuk është nxjerr vendim lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata vë theksin në faktin se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës mund të shqyrtohen nga gjykatat e rregullta, të cilat kanë mandatin që të shqyrtojnë çështjet që ngrit parashtruesi i kërkesës para Gjykatës konkretisht lidhur me padinë për *“kompensim material prej vitit 2008 deri më sot dhe kthim në punë si profesor në UP ose Rektor”*.

30. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese para se të shterojë të gjitha mjetet efektive të parapara në legjislacionin përkatës.
31. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
32. Në këtë mënyrë, duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduara (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI43/20, parashtrues, *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafi 13, si dhe rastin e Gjykatës KI19/20, parashtrues, *Lutfi Shantir*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrik 2020, paragrafi 36. Shih gjithashtu, rastin e GJEDNJ *Aksoy kundër Turqisë*, Aktgjykimit i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
33. Andaj, lidhur me këtë, Gjykata bazuar në praktikën e saj gjyqësore thekson se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër pranë gjykatave të rregullta, atëherë kërkesat e parashtruesve në Gjykatën Kushtetuese konsiderohen të parakohshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI09/19, parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2019, paragrafi 41; KI23/10, parashtruese *Jovica Gadžić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013, paragrafi 47; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
34. Gjykata potencon se ky Aktvendim për papranueshmëri nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen, sërish, të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor nga dita që ka pranuar vendimin të fundit, nga gjykatat e rregullta. Ky vendim i Gjykatës konstaton që, tani për tani, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme për arsye se legjislacioni në fuqi parasheh mjete efektive juridike përmes të cilave parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore dhe kushtetuese.
35. Rrjedhimisht, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (1) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 11 nëntor 2020 njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi